



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.66

Prishtinë, më 31.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi dhe Shpejtim Bulliqi.

Munguan: Sergjan Popoviq dhe Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik

Përfaqësues të ftuar: Ekspert i angazhuar nga Komisioni, Xhevdet Smakiqi

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 26.10.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 26.10.2016

Rendi i ditës dhe procesverbali i datës 26.10.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Nait Hasani e vlerësoi rëndësinë e Projektligjit duke e cilësuar si të domosdoshëm për zhvillimin dhe avancimin e fushave të cilat është paraparë t'i mbulojë ky Projektligj. Ai foli për përvojat e fituara nga vizita studimore lidhur me këtë Projektligj në Gjermani duke shpresuar që ato do të ndihmojnë në hartimin sa më të mirë të tij.

Anëtarët e Komisionit propozuan sugjerimet dhe komentet e tyre rreth Projektligjit dhe nga diskutimet e zhvilluara u propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit ndryshohet si vijon: **"LIGJ PËR SPONSORIZIME NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT"**

Amendamenti 2

Fshihet teksti si vijon: **"DISPOZITAT E PËRGJITHSHME"**.

Amendament 3

Në tërë tekstin e projektligjit fshihet fjala:
" donacione".

Amendamenti 4

Neni 1, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1.Ky ligj rregullon përkrahjen dhe mbështetjen financiare e materiale të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes sponsorizimeve dhe reklamave.

Amendament 5

Neni 2, paragrafi 1 fjala **"përcakton"** zëvendësohet me fjalën **"rregullon"**.

Amendamenti 6

Neni 2, nënparagrafi 1.2. fshihet.

Amendament 7

Neni 3, nënparagrafi 1.1 riformulohet si vijon:

1.1.**Sponsorizimi** – është mbështetje financiare dhe materiale në bazë të vullnetit të lirë që jepet nga personat fizik apo juridik të vendit dhe të huaj me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Sponsorizimi mundëson sponsorizuesve të promovojnë emrat, bizneset, logot dhe produktet e tyre me qëllim të shfrytëzimit të zbritjeve të lejuara për sponsorizim dhe lehtësirat administrative dhe tatimore shtese të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 3, nënparagrafi 1.2 fshihet.

Neni 3, nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon:

1.4. Interes i përgjithshëm publik – mbështetja e aktiviteteve të ndryshme në promovimin e kulturës, rinisë dhe sportit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Amendament 8

Në nenin 3, pas nënparagrafit 1.9 shtohet nënparagrafi i ri si vijon:

Reklama – promovim i logos ne fanella, ne objekte sportive, kulturore, rinore, në radio televizione, gazeta, revista, portale, afishe, tiketa, billborde dhe ueb faqe.

Amendamenti 9

Neni 4, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri si vijon:

1.Marrëveshja për sponsorizim dhe reklamë duhet të përmbaj: detyrimet e sponsorizuesit, kompensimin, ekskluzivitetin, mirëbesimin, shkëputjen, përjashtimin e përgjegjesisë, dënimin kontraktor, hyrjen në fuqi, kohëzgjatjen, formën e shkruar, ligjet e aplikueshme dhe gjykatën kompetente.

Neni 4, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

2. Lënda e marrëveshjes nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni nënkupton realizimin e interesit të përgjithshëm publik të caktuar me këtë ligj.

Amendament 10

Neni 5, riformulohet si vijon:

1. Me këtë Ligj njihen këto forma dhe lloje të sponsorizimit përmes:

1.1 Ofrimit të mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare të pagesës së shumës totale të sponsorizimit ose pagesës me këste, të cilat bëhen sipas legjislacionit në fuqi;

1.2.Ofrimit të pajisjeve muzikore, sportive dhe rekuizita tjera,

1.3. Ofrimit të mbështetjes për pjesëmarrje në gara dhe përgatitjet tjera menaxhuese, artistike dhe sportive;

1.4.Ofrimit të shërbimeve të transportit, të akomodimit dhe ushqimit për pjesëmarrësit në aktivitetet e sponsorizuara;

1.5.Ofrimit të shërbimeve të sigurisë;

1.6. Ofrimit të shërbimeve të rregullimit të ambientit dhe infrastrukturës së nevojshme;

2.Reklama realizohet përmes kontratës së noterizuar mes palëve.

Amendament 11

Neni 6 riformulohet si vijon:

1. Sponsorizuesit janë: individual, bashkësponsorizues, personat juridik të vendit dhe të huaj të cilët sponsorizojnë aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive.
2. Bashkësponsorizues janë dy apo më shumë persona juridik ose juridik të bashkuar me qëllim të mbështetjes të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.

Amendament 12

Neni 7, titulli dhe paragrafi 1 riformulohet:

Neni 7

Orientimi në fushën e sponsorizimit

1. Sponsorizuesi vlerëson varësisht nga interesi i tij/saj se në cilën fushë do të sponsorizojë në kulturë, rini apo sport.

Paragrafi 2 fshihet.

Amendamenti 13

Neni 8 riformulohet si vijon:

Neni 8

Kategorizimi dhe ndarja e sponsorizimeve

Kategorizimi dhe ndarja e sponsorizimit përcaktohet me marrëveshje ndërmjet subjekteve të marrëveshjes.

Amendamenti 14

Neni 9, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

2. Sponsorizuesi nuk mund të jetë personi fizik dhe personi juridik vendas apo i huaj, veprimtaria e të cilit është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës si dhe me marrëveshjet ndërkombëtarë që Republika e Kosovës i ka nënshkruar apo iu ka bashkuar.

Amendament 15

Neni 10, titulli riformulohet:

Neni 10

Te drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja e sponsorizimit

1. Përfituesi i sponsorizimit mund të jetë personi fizik apo juridik vendor i cili në emër të pranimit të sponsorizimit, duhet ti realizoj detyrimet të cilat dalin nga marrëveshja e nënshkruar për sponsorizim.

2.Të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Kosovës i ka nënshkruar apo ju ka bashkuar.

Amendamenti 16

Neni 11 riformulohet si vijon:

Sponsorizuesi dhe reklamuesi kanë të drejtë në zbritje të lejuara të përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Amendamenti 17

Neni 12 riformulohet si vijon:

1. Sponsorizuesit për sponsorizimet në aktivitetet e sportit u njihet zbritja 30% nga tatimi në fitim sipas këtij ligji.

2. Sponsorizuesit në sponsorizimet në fushën e kulturës dhe rinisë u njihet zbritja 20% nga tatimi në fitim në bazë të Ligjit Nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

3. Shpenzimet e reklamës në fanella sportive, objekte sportive dhe kulturore, përmes radios, televizionit, gazetave, revistave, portaleve, reklama të drejtpërdrejta, ueb faqe, posterat, afishet, tiketat, billbordet, reklamat tranzitë e të ngjashme janë shpenzime tërësisht të zbritshme për qëllime tatimore në përputhje me Ligjin Nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

4.Të hyrat nga sponsorizimet janë të hyra të pa-tatueshme për përfituesin e sponsorizimit.

5.Të hyrat nga reklamat janë të hyra të tatueshme për përfituesin e të hyrave nga reklamat, përjashtim nga kjo dispozitë bëjnë të hyrat nga reklamat që janë parashikuar në kontratën e sponsorizimit sipas dispozitave të këtij ligji.

Amendament 18

Neni 13 riformulohet si vijon:

Zbritjet e lejuara nuk mund të realizohen në rastet kur sponsorizimi ose reklama përdoret për aktivitete tjera që nuk janë të precizuara me marrëveshjen kontraktuale në mes të sponsorizuesit dhe reklamuesit që bien në kundërshtim me këtë ligj.

Amendament 19

Neni 14 paragrafi 2 dhe 3 riformulohen:

2. Marrëveshja për sponsorizim dhe reklamim me raportin financiar detyrimisht dorëzohen në ATK më së largu tridhjetë (30) ditë nga dita e përmbushjes –përfundimit të marrëveshjes.

3. Marrëveshja për sponsorizim, reklamim si dhe dokumentacioni tjetër i cili është i ndërlidhur me të duhet të ruhen më së paku pesë (5) vjet nga përfundimi i vitit kalendarik në të cilin është përmbush detyrimi nga marrëveshja.

Amendament 20

Neni 15, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. ATK - ja dhe organet kompetente mbikëqyrin dhënien, pranimin dhe shfrytëzimin e sponsorizimit dhe reklamimit për zbritjet e lejuara sipas këtij ligji.

Amendament 21

Neni 16, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

1. Me kërkesë të shfrytëzuesit të sponsorizimit, Ministria lëshon vërtetim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës me të cilin vërteton se sponsorizimi në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është interes i përgjithshëm publik i përcaktuar me këtë ligj dhe sipas nenit 10 të Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

Amendament 22

Neni 17 riformulohet si vijon:

1. Në shumën prej njëmijë (1.000) deri dhjetëmijë (10.000) euro dënohet për shkelje personi juridik – pranuesi i sponsorizimit, nëse:

1.1. nuk lidhë marrëveshje me shkrim me sponsorizuarin apo reklamuesin;

1.2. nuk ka përgatitur një raport për marrjen e sponsorizimit, reklamës;

1.3. nuk i shfrytëzon mjetet sipas marrëveshjes, ndërsa lënda e sponsorizimit do të kthehet dhënësit të sponsorizimit;

1.4. marrëveshja dhe dokumentet e tjera nuk ruhen së paku pesë (5) vite.

2. Nëse sponsorizuesi fizik apo juridik falsifikon dokumentacionin apo mashtron Ministrinë apo ATK-në, dënohet komfor dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Amendament 23

Neni 18 riformulohet si vijon:

Neni 18

Aktet nënligjore

Ministria në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Projektligji u diskutua nën për nen si dhe u dhanë arsyetimet për propozim ndryshimet për to.

Anëtarët e komisionit me shumicë votash katër për dhe një abstenim votuan propozim amendamentet dhe raporti i procedohet Komisioneve të përhershme për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Kjo pikë e rendit të ditës mbetet të diskutohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

5. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pat diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit
Nait Hasani**